

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**  
**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve**

**SKELETKURRIKULI**

**Për Profilin Mësimor**

**PUNIME DEKORATIVE DHE**  
**BOJATISJE**

**Niveli II**

**(Në drejtimin mësimor NDËRTIM)**

**Kodi: B5-II-18**

Miratoi:

MINISTRI

.....

## **Përmbajtja:**

- I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Punime dekorative dhe bojatisje”, niveli II, të drejtimit mësimor “Ndërtim”.**
- II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Punime dekorative dhe bojatisje”, niveli II.**
  1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Punime dekorative dhe bojatisje”, niveli II.
  2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Punime dekorative dhe bojatisje”, niveli II
  3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Punime dekorative dhe bojatisje”, niveli II
  4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit në në profilin “Punime dekorative dhe bojatisje”, niveli II.
- III. Plani mësimor për profilin “Punime dekorative dhe bojatisje”, niveli II.**
- IV. Udhëzime për planin mësimor.**
- V. Udhëzime për procesin mësimor.**
- VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**
- VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit në profilin “Punime dekorative dhe bojatisje”, niveli II.**
- VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.**
- IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.**
- X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar.**

## **I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Punime dekorative dhe bojatisje”, niveli II, të drejtimit “Ndërtim”.**

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në profilin “Punime dekorative dhe bojatisje”, niveli II, të drejtimit “Ndërtim”, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me punimet dekorative dhe të bojatisjes. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:*

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehjet, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

## **II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Punime dekorative dhe bojatisje”, niveli II**

### **1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Punime dekorative dhe bojatisje”, niveli II**

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në profilin mësimor “Punime dekorative dhe bojatisje” niveli II, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin profesional në drejtimin mësimor “Ndërtim”, niveli I;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- nëse kanë aftësi të kufizuara, shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, MFE përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

### **2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim arsimit në profilin “Punime dekorative dhe bojatisje”, niveli II**

Në përfundim të arsimit profesional në profilin “Punime dekorative dhe bojatisje”, niveli II, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.

- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efçente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale e rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënës të tij dhe të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

### **3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin mësimor “Punime dekorative dhe bojatisje”, niveli II.**

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional “Punime dekorative dhe bojatisje”, niveli II, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë më tej kompetencat profesionale të fituara në nivelin I, si dhe të ushtrojë kompetenca të tjera profesionale, si më poshtë:

- Të konceptojë planin për hapjen e një biznesi të vogël në veprimtaritë profesionale përkatëse.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me veprimtaritë profesionale përkatëse.
- Të bëjë organizimin e vogël të punës në punimet dekorative dhe të bojatisjes
- Të interpretojë, plotësojë dhe përgatisë dokumentacionin teknik të profesionit.
- Të kryejë punime dekorative me kartonxhes të mureve ndarëse, veshje të mureve ekzistuese dhe maskime të instalimeve të ndryshme.
- Të kryejë punime dekorative me kartonxhes të tavanëve të varur ose ekzistuese.
- Të kryejë punime të elementeve dekorative në mjedise të brendshme (korniza e rozeta tavanesh etj.) e të jashtme (fasada) (korniza perimetrale të dritareve).
- Të kryejë punime të elementeve të thjeshta dekorative në objekte restaurimi (fragment mur guri i dëmtuar dhe kyçi i qemerit hark me tulla mbi derën e jashtme).
- Të kryejë punime patinimi me materiale e teknika patinuese të ndryshme në sipërfaqe të suvatuara në mjedise të brendshme (mur, shtyllë, tra, korniza dritarësh etj.) e të jashtme (mur e tavan ballkoni).
- Të kryejë punime të veshjes me letër murale në sipërfaqe të brendshme.
- Të kryejë punime bojatisje me materiale e teknika bojatisje të ndryshme në sipërfaqe të suvatuara / patinuara të brendshme e të jashtme (fasada).
- Të kryejë punime bojatisje me materiale e teknika bojatisje të ndryshme në sipërfaqe prej druri e metali.
- Të përdorë dhe mirëmbajë veglat, pajisjet dhe materialet e punës.
- Të zbatojë standardet e profesionit gjatë kryerjes së punimeve
- Të zbatojë rregullat e sigurisë në punë, të mbrojtjes së mjedisit dhe MKZ.

#### 4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Punime dekorative dhe bojatisje”, niveli II.

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në profilin “Punime dekorative dhe bojatisje”, niveli II, e pajis nxënësin me çertifikatën e punonjësit të kualifikuar në këtë profil profesional. Ky arsimim i jep mundësi nxënësit t’i drejtohet tregut të punës për t’u punësuar në ndërmarrje ndërtimi, për t’u vetëpunësuar ose mbas një përvoje pune krijon një biznes të vogël në punimet dekorative dhe të bojatisjes, si dhe punëson të tjerë në të.

Me përfundimin e këtij niveli, nxënësi ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin III (teknik/manaxherial) të arsimit profesional (njëvjeçar) në drejtimin përkatës, për të fituar diplomën e “Maturës shtetërore profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve universitare dhe pas të mesmes.

### III. Plani mësimor për arsimin profesional në profilin mësimor “Punime dekorative dhe bojatisje”, niveli II

<b>Plani mësimor për profilin mësimor “Punime dekorative dhe bojatisje”, niveli II</b>			
<b>Nr</b>	<b>Kodi</b>	<b>Lëndët dhe modulet mësimore</b>	<b>Orët javore/vjetore</b>
			<b>Klasa 12</b>
<b>A.</b>		<b>Lëndët e përgjithshme</b> (Gjithsej)	<b>8/9</b> (272/306)
1		Gjuhë shqipe	1
2		Letërsi	1
3		Gjuhë e huaj e parë	2
4		Gjuhë e huaj e dytë (me zgjedhje të lirë)	(1)
5		Matematikë	2
6		TIK	1
7		Edukim fizik, sporte, shëndet	1
<b>B.</b>		<b>Lëndët profesionale</b> (Gjithsej)	<b>7</b> (238)
1	L-17-157-10	Bazat e sipërmarrjes	2
2	L-02-413-16	Vizatimet e ndërtimit dhe elementeve dekorative	1
3	L-02-414-16	Teknikë e punimeve dekorative	2
4	L-02-415-16	Teknikë e punimeve të patinimit dhe bojatisjes	1
5	L-02-416-16	Teknikë e konstruksioneve mbajtëse	1
<b>C.</b>		<b>Module të detyruar të praktikës profesionale</b> (Gjithsej)	<b>12</b> (408)
1	M-02-1278-16	Punimi dekorativ me kartonxhes i mureve dhe tavaneve	120
2	M-02-1279-16	Punimi i elementeve dekorative në mjedise të brendshme e të jashtme	69
3	M-02-1280-16	Punimi i elementeve të thjeshta dekorative në objekte restaurimi	69
4	M-02-1281-16	Punimi i patinimit në sipërfaqe të suvatuara, në mjedise të brendshme e të jashtme	66

5	M-02-1282-16	Punimi i veshjes me letër murale dhe bojatisjes në sipërfaqe të brendshme e të jashtme, druri e metali	84
<b>D.</b>		<b>Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar</b> (Gjithsej)	<b>3</b> (102)
1	M-02-1283-16	Punimi dekorativ i murit me taserina	102
2	M-02-1284-16	Punimi dekorativ i dyshemesë me mozaikë	102
		<b>Gjithsej A+B+C+D</b>	<b>30/31</b> (1020/ 1054)

#### IV. Udhëzime për planin mësimor

Në klasën 12, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (34 javë mësimore + 2 javë provime).

Një javë mësimore ka jo më shumë se 31 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në profilin “Punime dekorative dhe bojatisje”, niveli II, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MASR).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

#### V. Udhëzime për procesin mësimor

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që *planifikimi i mësimdhënies* të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritetit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxënit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të profilit mësimor “Punime dekorative dhe bojatisje”, niveli II.

Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehitë praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë

dy nga format bazë të organizimit të mësimit (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të profilit profesional “Punime dekorative dhe bojatisje”.

## **VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet**

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së 12-të, nxënësi i arsimuar në profilin mësimor “Punime dekorative dhe bojatisje”, niveli II, i nënshtrohet provimeve të mëposhtme:

- a) Provimi i teorisë profesionale të integruar;
- b) Provimi i praktikës profesionale të integruar.

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të kompetencave profesionale (njohurive, shprehive, vlerave dhe qëndrimeve), të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën e ndërtimit, dhe u jepet çertifikata në të cilën evidentohen notat përfundimtare të lëndëve teorike profesionale, të moduleve të praktikës profesionale, të lëndëve të përgjithshme, si dhe rezultatet e dy provimeve përfundimtare të nivelit II.

## **VII. Të dhëna për çertifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Punime dekorative dhe bojatisje”, niveli II**

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në profilin mësimor “Punime dekorative dhe bojatisje”, niveli II, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Dëftesën e përfundimit të këtij niveli si dhe me Çertifikatën e aftësisë profesionale, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga MFE, këto dëshmi përmbajnë:

- a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.
- b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:
  - rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale;
  - rezultatet e dy provimeve përfundimtare të Nivelit II.

## VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale

### 1. Lënda “Bazat e sipërmarrjes” (L-17-157-10). Kl. 12 – 68 orë

- Synimet e lëndës “ Bazat e sipërmarrjes”, kl. 12.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “ Bazat e sipërmarrjes”, kl.12, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë sipërmarrjen me të gjithë elementet kryesore të saj.
- Të shpjegojnë lidhjen midis sipërmarrjes dhe veprimtarisë njerëzore.
- Të shpjegojnë ndikimin e sipërmarrjes në biznes.
- Të shpjegojnë funksionet themelore të organizimit të punës në biznes.
- Të përshkruajnë veçoritë e tregut dhe veprimtaritë që kryhen në të.
- Të përshkruajnë llojet e konsumatorëve, kërkesat specifike për mallra/shërbime dhe reagimet e tyre ndaj sinjaleve të marketingut të një sipërmarrjeje.
- Të shpjegojnë kuptimin e institucioneve financiare dhe rolin e tyre në biznes.
- Të shpjegojnë kuptimin e bankave dhe shërbimet e tyre.
- Të shpjegojnë kuptimin, rëndësinë, mjetet dhe strategjitë e marketingut.
- Të listojnë katër \*P\*-të e marketingut.
- Të përshkruajnë konceptet bazë të legjislacionit dhe etikës së biznesit.
- Të shpjegojnë rëndësinë e legjislacionit të punës dhe elementet përbërës të tij.
- Të kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike të një aktiviteti sipërmarrës.
- Të shpjegojnë rëndësinë, nevojën dhe aspektet kryesore të përdorimit të Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve në biznes.

- Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12 - 68 orë

<b>Tema 1</b>	Njohuri të përgjithshme mbi sipërmarrjen	3 orë
<b>Tema 2</b>	Sipërmarrja dhe aktiviteti njerëzor	4 orë
<b>Tema 3</b>	Sipërmarrja dhe biznesi	8 orë
<b>Tema 4</b>	Organizimi i punës në biznes	9 orë
<b>Tema 5</b>	Tregu dhe sjellja konsumatore	6 orë
<b>Tema 6</b>	Institucionet financiare	7 orë
<b>Tema 7</b>	Njohuri për Marketingun	5 orë
<b>Tema 8</b>	Legjislacioni dhe etika e biznesit	5 orë
<b>Tema 9</b>	Legjislacioni i punës	7 orë
<b>Tema 10</b>	Llogaritje të thjeshta ekonomike	10 orë
<b>Tema 11</b>	Aspekte të TIK-ut në biznes	4 orë

### 2. Lënda “Vizatimet e ndërtimit dhe elementeve dekorative” (L-02-413-16). Kl. 12 - 34 orë

- Synimet e lëndës “Vizatimet e ndërtimit dhe elementeve dekorative”, kl. 12

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Vizatimet e ndërtimit dhe elementeve dekorative”, klasa 12, nxënësit duhet:

- Të interpretojnë në një projektzbatimi fletët e vizatimeve të ndërtimit.
- Të lexojnë shenjat dalluese që përdoren në fletët e vizatimeve të ndërtimit (arkitektonike, konstruktive e ato të instalimeve).



- Të vizatojnë shenjat dalluese që përdoren në fletët e vizatimeve të ndërtimit sipas tabelës së dhënë.
- Të përshkruajnë fazat e vizatimit të planimetrisë së themeleve dhe prerjeve të tyre.
- Të vizatojnë planimetrinë e themeleve të ndërtesës dhe prerjet e tyre sipas skicës së dhënë.
- Të përshkruajnë fazat e vizatimit të planimetrisë së kateve.
- Të vizatojnë planimetritë e kateve të ndërtesës sipas skicës së dhënë.
- Të përshkruajnë fazat e vizatimit të prerjeve.
- Të vizatojnë prerjet e ndërtesës sipas skicës së dhënë.
- Të përshkruajnë fazat e vizatimit të pamjeve.
- Të vizatojnë pamjet e ndërtesës sipas skicës së dhënë.
- Të përshkruajnë fazat e vizatimit të planit të strukturave të ndërkateve dhe shkallëve.
- Të përshkruajnë fazat e vizatimit të detajeve kryesore të ndërtesës.
- Të përshkruajnë fazat e vizatimit të detajeve kryesore të ndërtesës.
- Të vizatojnë detaje kryesore të ndërtesës.
- Të përshkruajnë fazat e vizatimit të detajeve të punimeve dekorative të mjediseve të brendshme të ndërtesës.
- Të vizatojnë detaje të punimeve dekorative të mjediseve të brendshme të ndërtesës.
- Të përshkruajnë fazat e vizatimit të detajeve të punimeve dekorative të mjediseve të jashtme (fasada) të ndërtesës.
- Të vizatojnë detaje të punimeve dekorative të mjediseve të jashtme të ndërtesës.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Vizatimet e ndërtimit dhe elementeve dekorative”, kl. 12- 34 orë:**

<b>Tema 1</b>	Vizatimet e ndërtimit dhe shenjat dalluese të tyre	4 orë
<b>Tema 2</b>	Planimetritë themeleve e kateve të ndërtesës dhe vizatimi i tyre	8 orë
<b>Tema 3</b>	Prerjet e ndërtesës dhe vizatimi i tyre	6 orë
<b>Tema 4</b>	Pamjet e ndërtesës dhe vizatimi i tyre	2 orë
<b>Tema 5</b>	Planet e strukturave të ndërkateve të ndërtesës dhe vizatimi i tyre	4 orë
<b>Tema 6</b>	Detajet kryesore të ndërtesës dhe vizatimi i tyre	4 orë
<b>Tema 7</b>	Detajet e punimeve dekorative në mjediset e brendshme dhe të jashtme (fasada) të ndërtesës dhe vizatimi i tyre	6 orë

**3. Lënda “Teknikë e punimeve dekorative” (L-02-414-16). Kl. 12 - 68 orë**

• **Synimet e lëndës “Teknikë e punimeve dekorative”, kl. 12**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Teknikë e punimeve dekorative”, klasa 12, nxënësit duhet:

- Të interpretojnë skica me përmasa të dhëna në planimetri dhe prerje për punimet dekorative në mure me kartonxhes.
- Të interpretojnë skica me përmasa të dhëna në planimetri dhe prerje për punimet dekorative në tavane të varura me kartonxhes.
- Të interpretojnë detaje arkitektonike me përmasa të dhëna në planimetri dhe prerje për objekte të ndryshme ndërtimi.
- Të interpretojnë skicat e punimeve dekorative në mjedise të brendshme (mure, shtylla, trarë, arktrarë etj).

- Të interpretojnë skica me përmasa të dhëna të elementeve dekorative në mjedise të jashtme (fasada).
- Të interpretojnë skica me përmasa të dhëna të elementeve dekorative të maskimit të instalimeve hidro-sanitare, elektrike, ngrohje-ventilim dhe audiovizive në objekte ndërtimi.
- Të përshkruajnë rrjetin e brendshëm dhe skemat e instalimeve të ndriçuesve në tavanet e varura.
- Të përshkruajnë llojet e materialeve, mjetet e punës, instrumentet matëse –nivelese dhe aksesoret për punimet dekorative dhe veshjet me kartonxhes.
- Të përshkruajnë teknikat e veshjes së mureve të brendshme me kartonxhes sipas skicës.
- Të përshkruajnë teknikat e realizimit të mureve të brendshme me kartonxhes sipas skicës.
- Të përshkruajë mënyrat e nivelimit të tavaneve të varura.
- Të përshkruajë teknikat e realizimit të tavaneve të varura me kartonxhes sipas konfiguracionit në skicë.
- Të dallojnë mënyrat dhe përshkruajnë hapat e maskimit të instalimeve hidro-sanitare, elektrike, ngrohje-ventilim dhe audiovizive në ndërtesë.
- Të dallojnë teknikat e përgatitjes së sipërfaqeve të brendshme nga ato të sipërfaqeve të jashtme.
- Të dallojnë teknikat bashkëkohore të dekorimit të sipërfaqeve brendshme dhe të jashtme.
- Të dallojnë elementet e ndryshme në punimet dekorative në mjedise të brendshme e të jashtme në objekte ndërtimi dhe të përshkruajnë teknikat e realizimit të tyre.
- Të përshkruajë teknikat e realizimit të veshjes me letër murale.
- Të përshkruajnë mënyrat e përgatitjes së elementeve të punimeve dekorative.
- Të përshkruajnë teknikat e përcaktimit të hapave të ndërhyrjeve të thjeshta në objekte restaurimi.
- Të dallojnë elementet e thjeshta dekorative të dëmtuara në objekte restaurimi dhe të përshkruajnë teknikat e restaurimit të tyre.
- Të dallojnë mënyrat e verifikimit të cilësisë së punimeve dekorative sipas skicës.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Teknikë e punimeve dekorative”, kl.12- 68 orë**

<b>Tema 1</b>	Skicimi dhe detajet për mure e tavane dekorative me kartonxhes	8 orë
<b>Tema 2</b>	Skicimi dhe detajet për elemente dekorative në mjedise të brendshme e të jashtme në objekte ndërtimi dhe restaurimi	8 orë
<b>Tema 3</b>	Skicimi dhe detajet e maskimit të instalimeve hidro-sanitare, elektrike, ngrohje-ventilim dhe audiovizive në objekte ndërtimi	4 orë
<b>Tema 4</b>	Teknika e punimit dekorativ të mureve me kartonxhes	8 orë
<b>Tema 5</b>	Teknika e punimit dekorativ të tavaneve të varura me kartonxhes	10 orë
<b>Tema 6</b>	Teknika e punimit dekorativ të maskimit të instalimeve hidro-sanitare, elektrike, ngrohje-ventilim dhe audiovizive në ndërtesë	4 orë
<b>Tema 7</b>	Teknika e punimit të elementeve dekorative në mjedise të brendshme dhe të jashtme në objekte ndërtimi	14 orë
<b>Tema 8</b>	Teknika e veshjes me letër murale	2 orë
<b>Tema 9</b>	Teknika e përcaktimit të hapave të ndërhyrjeve të thjeshta në objekte restaurimi	4 orë
<b>Tema 10</b>	Teknika e punimit të elementeve të thjeshta dekorative të dëmtuara në objekte restaurimi	6 orë

#### 4. Lënda “Teknikë e punimeve të patinimit dhe bojatisjes” (L-02-415-16). Kl. 12 - 34 orë

- Synimet e lëndës “Teknikë e punimeve të patinimit dhe bojatisjes”, kl. 12

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Teknikë e punimeve të patinimit dhe bojatisjes”, klasa 12, nxënësit duhet:

- Të nxjerrin të dhënat për punimet e patinimit dhe bojatisjes nga shënimet në projektin e zbatimit.
- Të përshkruajnë teknikat dhe materialet e përpunimit të sipërfaqeve të suvatuara të brendshme e të jashtme.
- Të dallojnë teknikat dhe materialet e patinimit në sipërfaqe të brendshme dhe të jashtme.
- Të përshkruajnë hapat e patinimit të tavaneve.
- Të përshkruajnë hapat e patinimit të mureve të brendshme.
- Të përshkruajnë hapat e patinimit të mureve të jashtme.
- Të përshkruajnë hapat e patinimit të tavaneve me kartonxhes.
- Të përshkruajnë hapat e patinimit të mureve me kartonxhes;
- Të dallojnë teknikat dhe materialet e bojatisjes në sipërfaqe të brendshme dhe të jashtme.
- Të përshkruajnë hapat e bojatisjes së tavaneve.
- Të përshkruajnë hapat e bojatisjes së mureve të brendshme.
- Të përshkruajnë hapat e bojatisjes së fasadave.
- Të përshkruajnë hapat e bojatisjes së tavaneve.
- Të përshkruajnë hapat e bojatisjes së elementeve dekorative në tavane.
- Të përshkruajnë hapat e bojatisjes së elementeve dekorative në mure të brendshme.
- Të përshkruajnë hapat e bojatisjes së elementeve dekorative në fasada.
- Të dallojnë llojet e sipërfaqeve të drurit për bojatisje.
- Të përshkruajnë hapat e bojatisjes së sipërfaqeve prej druri.
- Të përshkruajnë hapat e bojatisjes së sipërfaqeve prej metali

- Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “ Teknikë e punimeve të patinimit dhe bojatisjes”, kl.12- 34 orë

<b>Tema 1</b>	Nxjerrja e të dhënave për punimet e patinimit dhe bojatisjes nga shënimet në projekt	2 orë
<b>Tema 2</b>	Teknika e përpunimit të sipërfaqeve të suvatuara të brendshme e të jashtme	4 orë
<b>Tema 3</b>	Teknika e punimit të patinimit të sipërfaqeve të suvatuara	8 orë
<b>Tema 4</b>	Teknika e punimit të bojatisjes në mjedise të brendshme e të jashtme	10 orë
<b>Tema 5</b>	Teknika e punimit të bojatisjes në mure e tavane me kartonxhes dhe elemente dekorative	6 orë
<b>Tema 6</b>	Teknika e punimit të bojatisjes në sipërfaqe prej druri e metali	4 orë

#### 5. Lënda “Teknikë e konstruksioneve mbajtëse” (L-02-416-16). Kl. 12 - 34 orë

- Synimet e lëndës “ Teknikë e konstruksioneve mbajtëse”, kl. 12

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Teknikë e konstruksioneve mbajtëse”, klasa 12, nxënësit

duhet:

- Të rendisin llojet e konstruksioneve mbajtëse të ndërtesave.
- Të përshkruajnë elementet konstruktive përbërëse të konstruksioneve prej betoni të armuar.
- Të interpretojnë skica konstruktimi të elementeve të ndryshme konstruktive prej betoni të armuar.
- Të interpretojnë tabelën e sipërfaqes së armaturës së hekurit ( $F_a$ ) për elemente të ndryshme konstruktive prej betoni të armuar.
- Të përcaktojnë numrin dhe diametrin ( $n$  dhe  $\emptyset$ ) të shufrave për sipërfaqen  $F_a$  të dhënë për elemente të ndryshme konstruktive prej betoni të armuar me përmasa të dhëna.
- Të skicojnë shufrat e hekurit të gjetura, sipas modelit të dhënë për pllaka monolite prej betoni të armuar me një fushë dhe me konsola, si dhe pllakë të vazhduar me dy fusha.
- Të skicojnë shufrat e hekurit të gjetura, sipas modelit të dhënë për trarë monolitë prej betoni të armuar me një fushë dhe me konsola, si dhe trarë të vazhduar me dy fusha.
- Të skicojnë shufrat e hekurit të gjetura, sipas modelit të dhënë për pllakë të përzier me trarë prej betoni të armuar dhe mbushje me tulla me vrima me një fushë.
- Të skicojnë shufrat e hekurit të gjetura, sipas modelit të dhënë për plint monolit prej betoni të armuar të shkallëzuar dhe shtyllë monolite prej betoni të armuar dykatëshe me prerje katrore.
- Të skicojnë shufrat e hekurit të gjetura, sipas modelit të dhënë për shkallë monolite prej betoni të armuar me një dhe dy rampa.
- Të hartojnë tabelën e specifikimit të armaturës së hekurit për elementet e mësipërme prej betoni të armuar.
- Të përshkruajnë llojet dhe mënyrën e realizimit të konstruksioneve prej betoni të armuar të parapërgatitura e gjysmë të parapërgatitura.
- Të përshkruajnë llojet konstruksioneve mbajtëse prej guri e tulle.
- Të përshkruajnë llojet konstruksioneve mbajtëse prej druri e metali.

**Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Teknikë e konstruksioneve mbajtëse”,  
kl.12- 34 orë**

<b>Tema 1</b>	Konstruksionet mbajtëse dhe elementet konstruktive të tyre	3 orë
<b>Tema 2</b>	Parimet bazë për konstruktimin e elementeve prej betoni të armuar që punojnë në përkulje (pllaka dhe trarë)	10 orë
<b>Tema 3</b>	Parimet bazë për konstruktimin e elementeve prej betoni të armuar që punojnë në shtypje (shtylla)	4 orë
<b>Tema 4</b>	Parimet bazë për konstruktimin e themeleve prej betoni të armuar (pllakë dhe plinta)	4 orë
<b>Tema 5</b>	Parimet bazë për konstruktimin e shkallëve prej betoni të armuar	6 orë
<b>Tema 6</b>	Konstruksionet prej betoni të armuar me elemente të parapërgatitura e gjysmë të parapërgatitura	3 orë
<b>Tema 7</b>	Konstruksionet prej guri e tulle	2 orë
<b>Tema 8</b>	Konstruksionet prej druri e metali	2 orë

## IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

### 1. Moduli “Punimi dekorativ me kartonxhes i mureve dhe tavaneve”

**Drejtimi:** Ndërtim  
**Profili:** Punime dekorative dhe bojatisje  
**Niveli:** II  
**Klasa:** 12

#### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PUNIMI DEKORATIV ME KARTONXHES I MUREVE DHE TAVANEVE	M-02-1278-16
<b>Qëllimi i modulit</b>	Një modul praktik që i aftëson nxënësit të kryejnë punime dekorative me kartonxhes të mureve ndarëse, veshje të mureve ekzistuese e maskime të instalimeve të ndryshme, si dhe gjithashtu të kryejnë punime dekorative me kartonxhes të tavaneve të varur ose ekzistuese.	
<b>Kohëzgjatja e modulit</b>	120 orë mësimore	
<b>Niveli i parapëlqyer për pranim</b>	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Ndërtim”.	
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit</b>	<p><b>RM 1 Nxënësit interpretojnë skema të thjeshta të konstruksionit të murit dhe tavanit me kartonxhes.</b></p> <p><b>Përmbajtja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Udhëzime për rregullat e sigurimit teknik, të ruajtjes së mjedisit dhe MKZ për punime dekorative me kartonxhes të mureve dhe tavaneve.</li><li>– Leximi dhe interpretimi i fragmentit të planimetrisë për konstruksionin e murit me kartonxhes.</li><li>– Leximi dhe interpretimi i detajeve të elementeve përbërëse të konstruksionit të murit dhe tavanit me kartonxhes.</li><li>– Leximi i koordinatave dhe kuotave të konstruksionit të murit dhe tavanit me kartonxhes.</li><li>– Interpretimi i radhës së punimeve për punimin e murit dhe tavanit me kartonxhes.</li></ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Vëzhgim me listë kontrolli</li></ul> <p><b>Kriteret e vlerësimit:</b></p> <p>Nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>– të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik, të ruajtjes së mjedisit dhe MKZ për punime dekorativ me kartonxhes të mureve dhe tavaneve.</li><li>– të lexojnë dhe interpretojnë fragmentin e planimetrisë së dhënë të konstruksionit të murit me kartonxhes.</li><li>– të lexojnë dhe interpretojnë detajet e elementeve me</li></ul>	

---

aksesorët përkatës të konstruksionit të murit dhe tavanit me kartonxhes sipas skicës së dhënë.

- të lexojnë koordinatat dhe kuotat e konstruksionit të murit dhe tavanit me kartonxhes sipas skicës së dhënë.
- të interpretojnë radhën e punimeve murit dhe tavanit me kartonxhes sipas kushteve teknike.

## **RM 2 Nxënësit kryejnë punimin dekorativ me kartonxhes të murit.**

### ***Përmbajtja:***

- Përgatitja e vendit të punës, përzgjedhja e mjeteve dhe materialeve.
- Fiksimi i skelës së gatshme.
- Përcaktimi dhe shënimi i rrafshit vertikal të murit me kartonxhes.
- Përgatitja e skeletit metalik me profile për të dy faqet e murit dhe për hapësirat dyer - dritare.
- Montimi i elementeve të skeletit dhe fiksimi i tij në sipërfaqet ekzistuese (mur, shtyllë, tra, tavan, dysHEME).
- Përgatitja dhe montimi i paneleve kartonxhes nga njëra anë e murit.
- Përgatitja dhe fiksimi i shtresës termoizoluese në mes të murit.
- Përgatitja dhe montimi i paneleve kartonxhes nga ana tjetër e murit.
- Përgatitja dhe stukimi i këndoreve (mur, dyer – dritare).
- Ngjitja dhe stukimi i rrjetës për mbulimin e fugave.
- Pastrimi dhe mirëmbajtja e mjeteve të punës për punimin e murit me kartonxhes.
- Sistemimi i vendit të punës pas punimit të murit me kartonxhes.

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të përgatisin vendin e punës, të përzgjedhin mjetet dhe materialet e punës sipas kushteve teknike.
- të fiksojnë skelën e gatshme sipas kushteve teknike.
- të përcaktojnë dhe shënojnë rrafshin vertikal të murit me kartonxhes sipas skicës.
- të përgatisin elementet e skeletit metalik me profile për të dy anët e murit dhe për hapësirat dyer - dritare sipas përmasave në skicën e dhënë.
- të montojnë elementet për formimin e skeletit me aksesorët përkatës dhe ta fiksojnë atë në sipërfaqet ekzistuese (mur, shtyllë, tra, tavan, dysHEME), duke kontrolluar vertikalisht.
- të përgatisin dhe montojnë panelet kartonxhes nga njëra anë e murit sipas kushteve teknike.

- të përgatisin dhe fiksojnë shtresën termoizoluese në mes të murit sipas kushteve teknike.
- të përgatisin dhe montojnë panelet kartonxhes nga ana tjetër e murit sipas kushteve teknike.
- të përgatisin dhe stukojnë këndoret (mur, dyer – dritare) sipas kushteve teknike.
- të ngjisin dhe stukojnë rrjetën për mbulimin e fugave sipas kushteve teknike.
- të pastrojnë dhe mirëmbajnë mjetet e punës për punimin e murit me kartonxhes.
- të sistemojnë vendin e punës pas punimit të murit me kartonxhes.

### **RM 3 Nxënësit kryejnë punimin dekorativ me kartonxhes të tavanit të varur.**

#### ***Përmbajtja:***

- Përgatitja e vendit të punës, përzgjedhja e mjeteve dhe materialeve.
- Kontrolli i rrafshëtisë së tavanit ekzistues dhe shënimi e fiksimit të kuotave horizontale të tavanit të varur me kartonxhes.
- Vendosja e ganxhave për fiksimin e skeletit metalik.
- Përgatitja e elementeve të skeletit metalik me profile.
- Montimi i elementeve të skeletit në ganxhat.
- Përgatitja dhe montimi i paneleve me kartonxhes.
- Ngjitja dhe stukimi i rrjetës për mbulimin e fugave dhe bashkimin e tavanit me murin.
- Pastrimi dhe mirëmbajtja e mjeteve të punës për punimin e tavanit me kartonxhes.
- Sistemimi i vendit të punës pas punimit të tavanit me kartonxhes.

#### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

#### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të përgatisin vendin e punës, të përzgjedhin mjetet dhe materialet e punës sipas kushteve teknike.
- të kontrollojnë rrafshëtinë e tavanit ekzistues me instrumentet e kontrollit dhe të shënojnë e fiksojnë kuotat horizontale të tavanit me kartonxhes sipas skicës.
- të vendosin ganxhat në tavanin ekzistues për fiksimin e skeletit metalik në kuotat e përcaktuara sipas përmasave dhe konfiguracionit të tavanit të varur në skicën e dhënë.
- të përgatisin elementet e skeletit metalik me profile sipas përmasave dhe konfiguracionit të tavanit të varur në skicën e dhënë.
- të montojnë elementet për formimin e skeletit në ganxhat me aksesoret përkatës duke kontrolluar me instrumente matëse e niveluese sipas detajeve të dhëna në skicë.



- të përgatisin panelet me kartonxhes sipas përmasave dhe konfiguracionit të tavanit të varur në skicën e dhënë dhe t'i montojnë ato sipas detajeve e kushteve teknike.
- të ngjisin dhe stukojnë rrjetën për mbulimin e fugave dhe bashkimin e tavanit të varur me murin sipas kushteve teknike.
- të pastrojnë dhe mirëmbajnë mjetet e punës për punimin e tavanit të varur me kartonxhes.
- të sistemojnë vendin e punës pas punimit të tavanit të varur me kartonxhes.

**RM 4 Nxënësit kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike në punimet dekorative me kartonxhes të mureve dhe tavaneve.**

***Përmbajtja***

- Kostot në punimet dekorative me kartonxhes të mureve dhe tavaneve, si dhe përbërësit e kostove.
- Preventivi i materialeve, kostoja për materialet.
- Kostoja e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.).
- Kosto të tjera (transport, energji, amortizim pajisjesh, etj.).
- Detyrimet fiskale në bizneset e vogla në punimet dekorative me kartonxhes të mureve dhe tavaneve dhe llogaritja e tyre.
- Të ardhurat, fitimi, llogaritja e fitimit në një biznes të vogël për punimet dekorative me kartonxhes të mureve dhe tavaneve.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të njehsojnë kostot në punimet dekorative me kartonxhes të mureve dhe tavaneve, si dhe përbërësit e kostove, sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë preventivin e materialeve dhe koston e tyre, sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë koston e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë kostot e tjera (transport dhe makineri), sipas manualit përkatës.
- të llogaritin detyrimet fiskale në bizneset e vogla në punimet dekorative me kartonxhes të mureve dhe tavaneve, sipas formularëve përkatës.
- të llogaritin të ardhurat dhe fitimin në një biznes të vogël për punimet dekorative me kartonxhes të mureve dhe tavaneve.



---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në repartin e ndërtimit dhe në objekt ndërtimi.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë demonstrime konkrete të proceseve në punimet dekorative me kartonxhes të mureve dhe tavaneve.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve përgatitore në punimet dekorative me kartonxhes të mureve dhe tavaneve si dhe për përdorimin e mjeteve dhe instrumenteve matëse e niveluese.
- Nxënësit duhet të angazhohen në llogaritje konkrete të thjeshta ekonomike në punimet dekorative me kartonxhes të mureve dhe tavaneve.
- Mësuesi i praktikës duhet të mbikëqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit, MKZ dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe instrumenteve matëse e niveluese.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të përdorimit të mjeteve të punës në punimet dekorative me kartonxhes të mureve dhe tavaneve, si dhe të llogaritjeve të thjeshta ekonomike.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedis dhe objekt pune ndërtimi.
  - Komploti i mjeteve të montimit, shpimit dhe stukimit.
  - Instrumentet matëse e niveluese.
  - Komploti i veshjes së punës të montimit, shpimit dhe stukimit.
  - Materialet në punimet dekorative me kartonxhes të mureve dhe tavaneve:
    - Panele kartonxhes të llojeve të ndryshme,
    - Profile metalike,
    - Aksesorë të ndryshëm për skeletin dhe fiksimin e tij,
    - Ganxha,
    - Këndore,
    - Rrjetë vetëngjithëse,
    - Stuko patinimi
  - Shtresë termoizoluese polisteroli ose lesh xhami/druri/guri.
  - Makineri prerëse.
  - Skela të gatshme.
  - Pankarta në punimet dekorative me kartonxhes të mureve dhe tavaneve dhe detajet e aksesorët e tyre.
  - Projekte zbatimi së bashku me fletët e instalimeve elektrike, hidrosanitare, ngrohje-ventilim e audio-vizive.
  - Manuallet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
  - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e ndërtimit që lidhet me në punimet dekorative me kartonxhes të mureve dhe tavaneve (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
  - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

## 2. Moduli “Punimi i elementeve dekorative në mjedise të brendshme e të jashtme”

**Drejtimi:** Ndërtim  
**Profili:** Punime dekorative dhe bojatisje  
**Niveli:** II  
**Klasa:** 12

### PËRSHKRUESI I MODULIT

<b>Titulli dhe kodi</b>	<b>PUNIMI I ELEMENTEVE DEKORATIVE NË MJEDISE TË BRENDSHME E TË JASHTME</b>	<b>M-02-1279-16</b>
<b>Qëllimi i modulit</b>	Një modul praktik që i aftëson nxënësit në punimet dekorative në mjedise të brendshme (korniza e rozeta tavanesh etj.) e të jashtme (korniza perimetrale të dritareve në fasadë).	
<b>Kohëzgjatja e modulit</b>	69 orë mësimore	
<b>Niveli i parapëlqyer Për praninë</b>	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Ndërtim”.	
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit</b>	<p><b>RM 1 Nxënësit kryejnë punimet përgatitore në punimet dekorative në mjedise të brendshme e të jashtme (fasada).</b></p> <p><b>Përmbajtja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Udhëzime për rregullat e sigurimit teknik, të ruajtjes së mjedisit dhe MKZ në punimet dekorative në mjedise të brendshme e të jashtme (fasada).</li><li>– Njohja me mjedisin e brendshëm dhe të jashtëm (fasada) të objektit ku do të kryhen punimet dekorative.</li><li>– Leximi dhe interpretimi i skicave të elementeve dekorative që do të kryhen në mjedise të brendshme e të jashtme (fasada).</li><li>– Njohja me teknikat që do të përdoren për kryerjen e elementeve dekorative në mjedise të brendshme e të jashtme (fasada), si dhe me llojet e materialeve për to.</li><li>– Interpretimi i hapave të punimeve të elementeve dekorative në mjedise të brendshme e të jashtme (fasada).</li></ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Vëzhgim me listë kontrolli</li></ul> <p><b>Kriteret e vlerësimit:</b></p> <p>Nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>– të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik, të ruajtjes së mjedisit dhe MKZ për punimet e elementeve dekorative në mjedise të brendshme e të jashtme (fasada).</li><li>– të njohin mjedisin e brendshëm dhe të jashtëm (fasada) të objektit ku do të kryhen punimet e elementeve</li></ul>	

---

dekorative duke i specifikuar ato.

- të lexojnë dhe interpretojnë skicat e elementeve dekorative në mjedise të brendshme e të jashtme (fasada), duke i specifikuar ato.
- të njohin teknikat që do të përdoren për kryerjen e elementeve dekorative në mjedise të brendshme e të jashtme (fasada), duke i specifikuar ato, si dhe llojet e materialeve për to.
- të interpretojnë hapat e punimeve të elementeve dekorative në mjedise të brendshme e të jashtme (fasada), duke i specifikuar ato.

## **RM 2 Nxënësit kryejnë punime dekorative për korniza dhe rozetë tavanit.**

### ***Përmbajtja:***

- Përgatitja e vendit të punës, përzgjedhja e mjeteve dhe materialeve.
- Fiksimi i skelës së gatshme.
- Kontrolli i horizontalitetit dhe matja e përmasave të brinjëve perimetrale të tavanit për vendosjen e kornizave.
- Kontrolli i rrafshhtësisë së sipërfaqes së tavanit në vendin ku do të vendoset rozeta.
- Matja, shënimi dhe prerja e kornizave të gatshme.
- Përgatitja e materialit ngjitës.
- Ngjitja e kornizave në brinjët perimetrale të tavanit.
- Ngjitja e rozetës së tavanit.
- Pastrimi dhe mirëmbajtja e mjeteve të punës për punimin dekorativ të kornizave dhe rozetës së tavanit.
- Sistemimi i vendit të punës pas punimit dekorativ të kornizave dhe rozetës së tavanit.

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të përgatisin vendin e punës, të përzgjedhin mjetet dhe materialet e punës sipas projektit dhe kushteve teknike.
- të fiksojnë skelën e gatshme sipas kushteve teknike.
- të kontrollojnë me instrumente matëse-niveluese horizontalitetin e brinjëve perimetrale të tavanit për vendosjen e kornizave dhe të masin përmasat e brinjëve.
- të kontrollojnë rrafshhtësinë e sipërfaqes së tavanit me instrumente matëse-niveluese, në vendin ku do të vendoset rozeta.
- të masin, shënojnë dhe presin kornizat e gatshme sipas përmasave të brinjëve perimetrale të tavanit.
- të përgatisin e materialin ngjitës të llojit përkatës sipas materialit të kornizave dhe rozetës së tavanit.
- të ngjisin kornizat në brinjët perimetrale të tavanit duke i

- përputhur ato me sipërfaqet takuese.
- të ngjisin rozetën duke e përputhur atë me sipërfaqen e tavanit dhe kujdesur për kalimin në të të fijeve të ndriçimit në se ka.
- të pastrojnë dhe mirëmbajnë mjetet e punës për punimin dekorativ të kornizave dhe rozetës së tavanit.
- të sistemojnë vendin e punës pas punimit dekorativ të kornizave dhe rozetës së tavanit.

### **RM 3 Nxënësit kryejnë punim dekorativ të kornizës perimetrale të dritares në fasadë.**

#### ***Përmbajtja:***

- Përgatitja e vendit të punës, përzgjedhja e mjeteve dhe materialeve.
- Fiksimi i skelës së gatshme.
- Kontrolli i vertikalitetit dhe horizontalitetit të brinjëve perimetrale të dritares në fasadë dhe matja e tyre.
- Përgatitja e kallëp - shabllonit dhe fiksimi i tij në kornizën perimetrale të dritares në fasadë.
- Përgatitja e materialit mbushës (llaç etj.) për kornizën perimetrale të përcaktuar në projekt.
- Mbushja e kallëp – shabllonit me materialin e përgatitur.
- Heqja e kallëp - shabllonit për kornizën perimetrale të dritares në fasadë.
- Përpunimi i sipërfaqes së kornizës perimetrale të dritares në fasadë.
- Pastrimi dhe mirëmbajtja e mjeteve të punës për punimin dekorativ të kornizës perimetrale të dritares në fasadë.
- Sistemimi i vendit të punës pas punimit dekorativ të kornizës perimetrale të dritares në fasadë.

#### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

#### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të përgatisin vendin e punës, të përzgjedhin mjetet dhe materialet e punës sipas projektit dhe kushteve teknike.
- të fiksojnë skelën e gatshme sipas kushteve teknike.
- të kontrollojnë vertikalitetin dhe horizontalitetin e brinjëve perimetrale të dritares në fasadë me instrumente matëse-niveluese dhe t'i masin ato.
- të përgatisin kallëp – shabllonin për kornizën perimetrale të dritares në fasadë sipas konfiguracionit të dhënë në skicë, si dhe ta fiksojnë atë sipas kushteve teknike.
- të përgatisin materialin mbushës (llaç etj.) për kornizën perimetrale sipas llojit (llaç etj.) dhe recepturave të përcaktuara në projekt.
- të mbushin kallëp – shabllonin me materialin e përgatitur, duke respektuar kushtet teknike sipas llojit të tij dhe trashësisë së shtresës mbushëse.

- të heqin me kujdes pas ngurtësimit të materialit mbushës (llaç etj.) kallëp - shabllonin për kornizën perimetrale të dritares në fasadë.
- të përpunojnë sipërfaqen e kornizës perimetrale të dritares në fasadë sipas hollësive të dhëna në projekt.
- të pastrojnë dhe mirëmbajnë mjetet e punës për punimin dekorativ të sipërfaqes së kornizës perimetrale të dritares në fasadë.
- të sistemojnë vendin e punës pas punimit dekorativ të sipërfaqes së kornizës perimetrale të dritares në fasadë.

**RM 4 Nxënësi kryen llogaritje të thjeshta të punimit të elementeve dekorative në mjedise të brendshme e të jashtme (fasada).**

***Përmbajtja***

- Kostot në punimet e elementeve dekorative në mjedise të brendshme e të jashtme (fasada), përbërësit e kostove.
- Preventivi i materialeve, kostoja për materialet.
- Kostoja e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.).
- Kosto të tjera (transport, energji, amortizim pajisjesh, etj.).
- Detyrimet fiskale në bizneset e vogla në punimet e elementeve dekorative në mjedise të brendshme e të jashtme (fasada), si dhe llogaritja e tyre.
- Të ardhurat, fitimi, llogaritja e fitimit në një biznes të vogël në punimet e elementeve dekorative në mjedise të brendshme e të jashtme (fasada).

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të njehsojnë kostot në punimet e elementeve dekorative në mjedise të brendshme e të jashtme (fasada), si dhe përbërësit e kostove, sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë preventivin e materialeve dhe koston e tyre, sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë koston e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë kostot e tjera (transport, energji, amortizim pajisjesh, etj.), sipas manualit përkatës.
- të llogaritin detyrimet fiskale në bizneset e vogla në punimet e elementeve dekorative në mjedise të brendshme e të jashtme (fasada), sipas formularëve përkatës.
- të llogaritin të ardhurat dhe fitimin në një biznes të vogël në punimet e elementeve dekorative në mjedise të brendshme e të jashtme (fasada).

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në repartin e ndërtimit dhe objekte ndërtimi.
- Mësuesi i praktikës, duhet të përdorë demonstrime konkrete të proceseve në punimet e elementeve dekorative në mjedise të brendshme e të jashtme (fasada).
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve përgatitore në punimet e elementeve dekorative në mjedise të brendshme e të jashtme (fasada), si dhe për përdorimin e mjeteve dhe instrumenteve matëse e niveluese.
- Nxënësit duhet të angazhohen në llogaritje të thjeshta ekonomike në punimet e elementeve dekorative në mjedise të brendshme e të jashtme (fasada).
- Mësuesi i praktikës duhet të mbikëqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit, MKZ dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe instrumenteve matëse e niveluese.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të përdorimit të mjeteve të punës në punimet e elementeve dekorative në mjedise të brendshme e të jashtme (fasada), si dhe të llogaritjeve të thjeshta ekonomike.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedis pune dhe objekt ndërtimi.
  - Komplet i mjeteve të muratorit dhe patinuesit.
  - Instrumentet matëse e niveluese.
  - Komplet i veshjes së punës së muratorit dhe patinuesit.
  - Materialet për realizimin e elementeve dekorative :
    - Korniza tavani të gatshme me profile dhe materiale të ndryshme (allçi, polisterol),
    - Rozeta tavani të gatshme me konfiguracione, profile dhe materiale të ndryshme (allçi, polisterol),
    - Rërë, granil i hollë, çimento, gëlqere, ujë,
    - Kubik llaçi me lartësi 25 cm,
    - Kovë metalike 15 litra,
    - Dërrasa për kallëp - shabllon, gozhdë,
  - Skela të gatshme.
  - Pankarta dhe skica për punimet e elementeve dekorative (korniza e rozeta tavani dhe korniza perimetrale në dritare në fasadë) me detajet e tyre.
  - Projekte zbatimi.
  - Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
  - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e ndërtimit që lidhet me punimet e elementeve dekorative në mjedise të brendshme e të jashtme (fasada).
  - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

### 3. Moduli “Punimi i elementeve të thjeshta dekorative në objekte restaurimi”

**Drejtimi:** Ndërtim  
**Profili:** Punime dekorative dhe bojatisje  
**Niveli:** II  
**Klasa:** 12

#### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PUNIMI I ELEMENTEVE TË THJESHTA DEKORATIVE NË OBJEKTE RESTAURIMI	M-02-1280-16
<b>Qëllimi i modulit</b>	Një modul praktik që i aftëson nxënësit në punimet elementeve të thjeshta dekorative (fragment i dëmtuar në mur guri dhe te kyçi i qemerit hark me tulla mbi derën e jashtme) sipas modelit ekzistues në objekte restaurimi.	
<b>Kohëzgjatja e modulit</b>	69 orë mësimore	
<b>Niveli i parapëlqyer Për pranim</b>	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Ndërtim”.	
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit</b>	<p><b>RM 1 Nxënësit kryejnë punimet përgatitore në punimet e elementeve të thjeshta dekorative sipas modelit ekzistues në objekte restaurimi.</b></p> <p><b>Përmbajtja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Udhëzime për rregullat e sigurimit teknik, të ruajtjes së mjedisit dhe MKZ në punimet e elementeve të thjeshta dekorative sipas modelit ekzistues në objekte restaurimi.</li><li>– Njohja me mjedisin e brendshëm dhe të jashtëm (fasada) të objektit ku do të kryhen punimet restauruese.</li><li>– Leximi dhe interpretimi i skicave të elementeve të thjeshta dekorative që do të kryhen sipas modelit ekzistues në objekte restaurimi.</li><li>– Njohja me teknikat që do të përdoren për kryerjen e punimeve restauruese për elemente të thjeshta dekorative sipas modelit ekzistues në objekte restaurimi, si dhe me llojet e materialeve për to.</li><li>– Interpretimi i hapave të punimeve të elementeve të thjeshta dekorative sipas modelit ekzistues në objekte restaurimi.</li></ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Vëzhgim me listë kontrolli</li></ul> <p><b>Kriteret e vlerësimit:</b></p> <p>Nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>– të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik, të ruajtjes së</li></ul>	

---

mjedisit dhe MKZ për punimet e elemente të thjeshta dekorative sipas modelit ekzistues në objekte restaurimi.

- të njohin mjedisin e brendshëm dhe të jashtëm (fasada) të objektit ku do të kryhen punimet restauruese, duke i specifikuar ato.
- të lexojnë dhe interpretojnë skicat e elementeve të thjeshta dekorative që do të kryhen sipas modelit ekzistues në objekte restaurimi, duke i specifikuar ato sipas projektit.
- të njohin teknikat që do të përdoren për kryerjen e punimeve për elemente të thjeshta dekorative në objekte restaurimi sipas modelit ekzistues, duke i specifikuar ato sipas projektit, si dhe llojet e materialeve për to.
- të interpretojnë hapat e punimeve të elementeve të thjeshta dekorative sipas modelit ekzistues në objekte restaurimi, duke i specifikuar ato.

## **RM 2 Nxënësit kryejnë punim dekorativ për fragment të dëmtuar muri me gurë.**

### ***Përmbajtja:***

- Përgatitja e vendit të punës, përzgjedhja e mjeteve dhe materialeve.
- Fiksimi i skelës së gatshme.
- Kontrolli i qëndrueshmërisë së murit dhe përforcimi i tij.
- Kontrolli i vertikalishtet e rrafshhtësisë së murit dhe matja e përmasave të zonës së dëmtuar e pastrimi i saj.
- Përgatitja e gurëve plotësues për zonën e dëmtuar të murit.
- Përgatitja e materialit ngjitës (llaçit).
- Vendoja e gurëve në zonën e dëmtuar të murit dhe ngjitja e tyre me llaç.
- Përpunimi i fugave të muraturës.
- Pastrimi dhe mirëmbajtja e mjeteve të punës për punimin dekorativ të fragmentit të murit me gurë.
- Sistemimi i vendit të punës pas punimit dekorativ të fragmentit të murit me gurë.

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të përgatisin vendin e punës, të përzgjedhin mjetet dhe materialet e punës sipas projektit dhe kushteve teknike.
- të fiksojnë skelën e gatshme sipas kushteve teknike.
- të kontrollojnë qëndrueshmërisë e murit dhe ta përforcojnë atë sipas kushteve teknike.
- të kontrollojnë me instrumente matëse-niveluese vertikalishtetin e rrafshhtësinë e murit dhe të masin



- përmasat e zonës së dëmtuar e ta pastrojnë atë sipas kushteve teknike.
- të përgatisin gurët plotësues për zonën e dëmtuar të murit sipas llojit dhe konfiguracionit të tyre në murin ekzistues.
- të përgatisin materialin ngjitës (llaçin) sipas llojit dhe recepturave në projekt, të bazuar në analizën e llaçit ekzistues.
- të vendosin gurët në zonën e dëmtuar të murit sipas konfiguracionit të tyre në murin ekzistues dhe t'i ngjisin ata me llaçin e përgatitur sipas kushteve teknike.
- të përpunojnë fugat e muraturës sipas konfiguracionit të tyre në murin ekzistues.
- të pastrojnë dhe mirëmbajnë mjetet e punës për punimin dekorativ të fragmentit të murit me gurë.
- të sistemojnë vendin e punës pas punimit dekorativ të fragmentit të murit me gurë.

**RM 3 Nxënësit kryejnë punim dekorativ të kyçit të dëmtuar të qemerit hark me tulla të derës në fasadë.**

***Përmbajtja:***

- Përgatitja e vendit të punës, përzgjedhja e mjeteve dhe materialeve.
- Fiksimi i skelës së gatshme.
- Kontrolli i qëndrueshmërisë së qemerit hark me tulla të derës në fasadë dhe përforcimi i tij.
- Kontrolli i vertikalishtet e rrafshhtësisë së planit të qemerit hark me tulla dhe matja e përmasave të kyçit të dëmtuar e pastrimi i tij.
- Përgatitja e shabllonit dhe fiksimi i tij në qemerin hark me tulla të derës në fasadë.
- Përgatitja e tullave për kyçin e qemerit hark.
- Përgatitja e llaçit për ngjitjen e tullave të kyçit.
- Vendoja e tullave të kyçit në zonën e dëmtuar të qemerit hark dhe ngjitja e tyre me llaç.
- Përpunimi i fugave të tullave të kyçit.
- Heqja e shabllonit për të qemerin hark.
- Pastrimi i sipërfaqes së punuar të qemerit hark.
- Pastrimi dhe mirëmbajtja e mjeteve të punës për punimin dekorativ të kyçit të qemerit hark me tulla të dritares në fasadë.
- Sistemimi i vendit të punës pas punimit dekorativ të kyçit të qemerit hark me tulla të dritares në fasadë.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të përgatisin vendin e punës, të përzgjedhin mjetet dhe materialet e punës sipas projektit dhe kushteve teknike.

- të fiksojnë skelën e gatshme sipas kushteve teknike.
- të kontrollojnë qëndrueshmërinë e qemerit hark me tulla të derës në fasadë me instrumente matëse-niveluese dhe ta përforcojnë atë sipas kushteve teknike.
- të kontrollojnë vertikalishtet e rrafshëtisë së planit të qemerit hark me tulla instrumente matëse-niveluese dhe të masin përmasat e kyçit të dëmtuar e ta pastrojnë atë
- të përgatisin shabllonin sipas skicës me konfiguracionin ekzistues të qemerit hark me tulla si dhe ta fiksojnë atë në qemer sipas kushteve teknike.
- të përgatisin tullat për kyçin e qemerit hark sipas skicës me konfiguracionin ekzistues.
- të përgatisin llaçin për ngjitjen e tullave të kyçit sipas llojit dhe recepturave të përcaktuara në projekt.
- të vendosin tullat e kyçit në zonën e dëmtuar të qemerit hark dhe t'i ngjisin ato me llaç sipas kushteve teknike .
- të përpunojnë fugat e tullave të kyçit sipas fugave ekzistuese të qemeri hark.
- të heqin me kujdes pas ngurtësimit të llaçit shabllonin për qemerin hark.
- të pastrojnë me kujdes sipërfaqen e e punuar te qemeri hark me tulla.
- të pastrojnë dhe mirëmbajnë mjetet e punës për punimin dekorativ të kyçit në zonën e dëmtuar të qemerit hark me tulla.
- të sistemojnë vendin e punës pas punimit dekorativ të kyçit në zonën e dëmtuar të qemerit hark me tulla.

#### **RM 4 Nxënësi kryen llogaritje të thjeshta të punimit të elementeve të thjeshta dekorative në objekte restaurimi.**

##### ***Përmbajtja***

- Kostot në punimet e elementeve të thjeshta dekorative në objekte restaurimi, përbërësit e kostove.
- Preventivi i materialeve, kostoja për materialet.
- Kostoja e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.).
- Kosto të tjera (transport, energji, amortizim pajisjesh, etj.).
- Detyrimet fiskale në bizneset e vogla në punimet e elementeve të thjeshta dekorative në objekte restaurimi, si dhe llogaritja e tyre.
- Të ardhurat, fitimi, llogaritja e fitimit në një biznes të vogël në punimet e elementeve të thjeshta dekorative në objekte restaurimi.

##### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

##### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të njehsojnë kostot në punimet e elementeve të thjeshta

dekorative në objekte restaurimi, si dhe përbërësit e kostove, sipas manualit përkatës.

- të njehsojnë preventivin e materialeve dhe koston e tyre, sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë koston e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë kostot e tjera (transport, energji, amortizim pajisjesh, etj.), sipas manualit përkatës.
- të llogaritin detyrimet fiskale në bizneset e vogla në punimet e elementeve të thjeshta dekorative në objekte restaurimi, sipas formularëve përkatës.
- të llogaritin të ardhurat dhe fitimin në një biznes të vogël në punimet e elementeve të thjeshta dekorative në objekte restaurimi.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në repartin e ndërtimit dhe objekte që restaurohen.
- Mësuesi i praktikës, duhet të përdorë demonstrime konkrete të proceseve në punimet e elementeve të thjeshta dekorative në objekte restaurimi.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve përgatitore në punimet e elementeve të thjeshta dekorative në objekte restaurimi, si dhe për përdorimin e mjeteve dhe instrumenteve matëse e niveluese.
- Nxënësit duhet të angazhohen në llogaritje të thjeshta ekonomike në punimet e elementeve të thjeshta dekorative në objekte restaurimi.
- Mësuesi i praktikës duhet të mbikëqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit, MKZ dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe instrumenteve matëse e niveluese.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të përdorimit të mjeteve të punës në punimet e elementeve të thjeshta dekorative në objekte restaurimi, si dhe të llogaritjeve të thjeshta ekonomike.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedis pune dhe objekt që restaurohet.
  - Komploti i mjeteve të muratorit dhe patinuesit.
  - Instrumentet matëse e niveluese.
  - Komploti i veshjes së punës të muratorit dhe patinuesit.
  - Materialet për realizimin e të thjeshta dekorative në objekte restaurimi:
    - Gurë me me përmasa të ndryshme,
    - Tulla të kuqe të plota,
    - Rërë, çimento, gëlqere, ujë,
    - Kubik llaçi me lartësi 25 cm,
    - Kovë metalike 15 litra,

- 
- Dërrasa për shabllon e përforcime, gozhdë,
  - Skela të gatshme.
  - Pankarta dhe skica për punimet e elementeve të thjeshta dekorative në objekte restaurimi me detajet e tyre.
  - Projekte zbatimi.
  - Manuallet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
  - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e ndërtimit që lidhet me punimet e elementeve të thjeshta dekorative në objekte restaurimi.
  - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

#### 4. Moduli “Punimi i patinimit në sipërfaqe të suvatuara në mjedise të brendshme e të jashtme”

**Drejtimi:** Ndërtim  
**Profili:** Punime dekorative dhe bojatisje  
**Niveli:** II  
**Klasa:** 12

##### PËRSHKRUESI I MODULIT

<b>Titulli dhe kodi</b>	<b>PUNIMI I PATINIMIT NË SIPËRFAQE TË SUVATUARA, NË MJEDISE TË BRENDSHME E TË JASHTME</b>	<b>M-02-1281-16</b>
<b>Qëllimi i modulit</b>	Një modul praktik që i aftëson nxënësit në punimet e patinimit në sipërfaqe të suvatuara në mjedise të brendshme (mur, shtyllë, tra, korniza dritaresh etj.) e të jashtme mur e tavan ballkoni).	
<b>Kohëzgjatja e modulit</b>	66 orë mësimore	
<b>Niveli i parapëlqyer Për praninë</b>	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Ndërtim”.	
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit</b>	<p><b>RM 1 Nxënësit kryejnë punimet përgatitore për patinimin në sipërfaqe të suvatuara në mjedise të brendshme e të jashtme.</b></p> <p><b>Përmbajtja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Udhëzime për rregullat e sigurimit teknik, të ruajtjes së mjedisit dhe MKZ për punimin e patinimit në sipërfaqe të suvatuara në mjedise të brendshme e të jashtme.</li><li>– Njohja me mjedisin e brendshëm me mure të suvatuara të cilat do të patinohen.</li><li>– Njohja me mjedisin e jashtëm me mure dhe tavane ballkonesh të suvatuara të cilat do të patinohen.</li><li>– Njohja me teknikat që përdoren për patinimin në sipërfaqe të suvatuara në mjedise të brendshme e të jashtme.</li><li>– Njohja me hapat e realizimit të patinimeve me teknika e materiale të ndryshme patinimi.</li></ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Vëzhgim me listë kontrolli</li></ul> <p><b>Kriteret e vlerësimit:</b></p> <p>Nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>– të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit dhe MKZ për punimin e patinimit në sipërfaqe të suvatuara në mjedise të brendshme e të jashtme.</li><li>– të njohin mjedisin e brendshëm me mure të suvatuara</li></ul>	

---

të cilat do të patinohen duke vlerësuar përpunimin e sipërfaqes.

- të njohin mjedisin e jashtëm me mure dhe tavane ballkonesh të suvatuara të cilat do të patinohen duke vlerësuar përpunimin e sipërfaqes.
- të njohin teknikat që përdoren për patinimin në sipërfaqe të suvatuara në mjedise të brendshme e të jashtme sipas kërkesës.
- të njohin hapat e realizimit të patinimeve me teknika e materiale të ndryshme patinimi sipas kërkesës.

## **RM 2 Nxënësit kryejnë punime patinimi në sipërfaqe të suvatuara në mjedise të brendshme e të jashtme.**

### ***Përmbajtja:***

- Përgatitja e vendit të punës, përzgjedhja e mjeteve dhe materialeve.
- Fiksimi i skelës së gatshme për patinimin e mjediseve të brendshme dhe të jashtme.
- Pastrimi nga pluhurat i sipërfaqeve të suvatuara në mjediset e brendshme (mure, shtylla, trarë, korniza të dritareve etj.) dhe në mjediset e jashtme (mure e tavane ballkonesh).
- Vendosja e letrës ngjitëse në kufirin e sipërfaqes që patinohet me objektet e tjera (kornizat e dyer – dritareve, davancaleve, plintusave, prizave etj.).
- Stukimi në zonat e dëmtuara të sipërfaqeve ekzistuese në mjediset e brendshme dhe të jashtme.
- Smerilimi i zonave të stukuara.
- Bojatisja me prajmer e sipërfaqeve të përpunuara.
- Përgatitja e materialit patinues.
- Patinimi i sipërfaqeve në mjediset e brendshme (mure, shtylla, trarë, korniza të dritareve etj.) dhe të jashtme (mure e tavane ballkonesh).
- Heqja e letrës ngjitëse dhe pastrimi i sipërfaqeve të ndotura.
- Pastrimi dhe mirëmbajtja e mjeteve të punës për punimet e patinimit në sipërfaqe të suvatuara në mjedise të brendshme dhe të jashtme.
- Sistemimi i vendit të punës pas punimit të patinimit në sipërfaqeve të suvatuara në mjedise të brendshme dhe të jashtme.

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të përgatisin vendin e punës, të përzgjedhin mjetet dhe materialet e punës sipas kushteve teknike.
- të fiksojnë skelën e gatshme për patinimin e mjediseve të brendshme dhe të jashtme sipas kushteve teknike.

- të pastrojnë nga pluhurat sipërfaqet e suvatuara në mjediset e brendshme (tavane, mure, shtylla, trarë, korniza të dritareve etj.) dhe në mjediset e jashtme (mure e tavane ballkonesh) sipas kushteve teknike.
- të vendosin me saktësi letrën ngjitëse në kufirin e sipërfaqes që patinohet me objektet e tjera (kornizat e dyer – dritareve, davancaleve, plintusave, prizave etj.).
- të stukojnë me stuko patinimi zonat e dëmtuara të sipërfaqeve ekzistuese në mjediset e brendshme dhe të jashtme sipas kushteve teknike.
- të smerilojnë zonat e stukuara sipas kushteve teknike.
- të bojatisin me prajmer sipërfaqet e përpunuara.
- të përgatisin materialin patinues sipas kërkesës për llojin e tij.
- të patinojnë sipërfaqet në mjediset e brendshme (mure, shtylla, trarë, korniza të dritareve etj.) dhe të jashtme (mure e tavane ballkonesh) sipas kushteve teknike për teknikën patinuese përkatëse.
- të heqin me kujdes letrën ngjitëse dhe të pastrojnë nga njollat e mbeturinat sipërfaqet e plintusave, dyshemesë, davancaleve, dyer – dritareve, parapeteve etj.
- të pastrojnë dhe mirëmbajnë mjetet e punës për punimet e patinimit në sipërfaqe të suvatuara në mjedise të brendshme dhe të jashtme.
- të sistemojnë vendin e punës pas punimit të patinimit në sipërfaqe të suvatuara në mjedise të brendshme dhe të jashtme.

### **RM 3 Nxënësit kryejnë llogaritje të thjeshta për punimin e patinimit në sipërfaqe të suvatuara në mjedise të brendshme dhe të jashtme.**

#### ***Përmbajtja***

- Kostot në punimin e patinimit në sipërfaqe të suvatuara në mjedise të brendshme dhe të jashtme, përbërësit e kostove.
- Preventivi i materialeve, kostoja për materialet.
- Kostoja e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.).
- Kosto të tjera (transport, energji, amortizim pajisjesh, etj.).
- Detyrimet fiskale në bizneset e vogla për punimin e patinimit në sipërfaqe të suvatuara në mjedise të brendshme dhe të jashtme, si dhe llogaritja e tyre.
- Të ardhurat, fitimi, llogaritja e fitimit në një biznes të vogël për punimin e patinimit në sipërfaqe të suvatuara në mjedise të brendshme dhe të jashtme.

#### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

#### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të njehsojnë kostot në punimin e patinimit në sipërfaqe të suvatuara në mjedise të brendshme dhe të jashtme, si dhe përbërësit e kostove, sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë preventivin e materialeve dhe koston e tyre, sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë koston e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë kostot e tjera (transport, energji, amortizim pajisjesh, etj.), sipas manualit përkatës.
- të llogaritin detyrimet fiskale në bizneset e vogla për punimin e patinimit në sipërfaqe të suvatuara në mjedise të brendshme dhe të jashtme, sipas formularëve përkatës.
- të llogaritin të ardhurat dhe fitimin në një biznes të vogël për punimin e patinimit në sipërfaqe të suvatuara në mjedise të brendshme dhe të jashtme.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në repartin e ndërtimit dhe objekte ndërtimi.
- Mësuesi i praktikës, duhet të përdorë demonstrime konkrete të proceseve për punimin e patinimit në sipërfaqe të suvatuara në mjedise të brendshme dhe të jashtme.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve përgatitore për punimin e patinimit në sipërfaqe të suvatuara në mjedise të brendshme dhe të jashtme, si dhe për përdorimin e mjeteve dhe instrumenteve matëse e niveluese.
- Nxënësit duhet të angazhohen në llogaritje të thjeshta ekonomike të punimit të punimin e patinimit në sipërfaqe të suvatuara në mjedise të brendshme dhe të jashtme.
- Mësuesi i praktikës duhet të mbikëqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit, MKZ dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe instrumenteve matëse e niveluese.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të përdorimit të mjeteve të punës për punimin e patinimit në sipërfaqe të suvatuara në mjedise të brendshme dhe të jashtme, si dhe të llogaritjeve të thjeshta ekonomike.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedis dhe objekt pune ndërtimi.
  - Komploti i mjeteve të patinimit, stukimit dhe bojatisjes.
  - Instrumentet matëse e niveluese.
  - Komploti i veshjes së punës për patinimin, stukimin dhe bojatisjen.
  - Materialet për patinimin:
    - Materiale të ndryshme patinimi,
-



- 
- Katalogu i materialeve patinuese,
  - Prajmer për bojatisjen e sipërfaqeve të pastruara,
  - Letër ngjithëse për kufizimin e sipërfaqeve që patinohen,  
Stuko të ndryshme patinimi.
  - Skela të gatshme.
  - Pankarta për punimin e patinimit në sipërfaqe të suvatuara në mjedise të brendshme dhe të jashtme me detajet e tyre për teknika të ndryshme patinimi.
  - Projekte zbatimi.
  - Manuallet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
  - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e ndërtimit që lidhet me punimin e patinimit në sipërfaqe të suvatuara në mjedise të brendshme dhe të jashtme (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
  - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

## 5. Moduli “Punimi i veshjes me letër murale dhe bojatisjes në sipërfaqe të brendshme e të jashtme, druri e metali”

**Drejtimi:** Ndërtim  
**Profili:** Punime dekorative dhe bojatisje  
**Niveli:** II  
**Klasa:** 12

### PËRSHKRUESI I MODULIT

<b>Titulli dhe kodi</b>	<b>PUNIMI I VESHJES ME LETER MURALE DHE BOJATISJES NË SIPËRFAQE TË BRENDSHME E TË JASHTME, DRURI E METALI</b>	<b>M-02-1282-16</b>
<b>Qëllimi i modulit</b>	Një modul praktik që i aftëson nxënësit në punimet e veshjes me letër murale; në punime bojatisje me materiale e teknika bojatisje të ndryshme në sipërfaqe të suvatuara / patinuara të brendshme e të jashtme (fasada); në punime bojatisje me materiale e teknika bojatisje të ndryshme në sipërfaqe prej druri e metali.	
<b>Kohëzgjatja e modulit</b>	84 orë mësimore	
<b>Niveli i parapëlqyer Për pranim</b>	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Ndërtim”.	
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit</b>	<p><b>RM 1 Nxënësit kryejnë punimet përgatitore për veshjen me letër murale dhe bojatisjen në sipërfaqe të brendshme e të jashtme (fasada) dhe prej druri e metali.</b></p> <p><b>Përmbajtja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Udhëzime për rregullat e sigurimit teknik, të ruajtjes së mjedisit dhe MKZ për punimin e veshjes me letër murale dhe bojatisjes në sipërfaqe të brendshme e të jashtme (fasada) dhe prej druri e metali.</li> <li>– Njohja me mjedisin, muret e të cilët do të vishen me letër murale dhe katalogun e tyre.</li> <li>– Njohja me mjedisin e brendshëm dhe fasadën, muret e të cilave do të bojatisen.</li> <li>– Njohja me katalogun e ngjyrave dhe llojin e bojërave që përdoren për bojatisjen në sipërfaqe të brendshme e të jashtme (fasada).</li> <li>– Njohja me hapat e punimit me dorë dhe në kompjuter për përgatitjen e bojërave.</li> <li>– Njohja me sipërfaqet prej druri e metali që do të bojatisen.</li> <li>– Njohja me llojin e bojërave që përdoren për bojatisjen në sipërfaqe prej druri e metali.</li> </ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Vëzhgim me listë kontrolli</li> </ul>	

---

**Kriteret e vlerësimit:**

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit dhe MKZ për punimin e veshjes me letër murale dhe bojatisjes në sipërfaqe të brendshme e të jashtme (fasada) dhe prej druri e metali.
- të njohin mjedisin, muret e të cilit do të vishen me letër murale dhe katalogun e tyre duke përcaktuar llojin e letrës murale sipas kërkesës.
- të njohin mjedisin e brendshëm dhe fasadën, muret e të cilave do të bojatisen duke specifikuar përpunimin e tyre para bojatisjes.
- të njohin katalogun e ngjyrave dhe llojin të bojërave që do të përdoren në sipërfaqe të ndryshme duke specifikuar përpunimin e tyre para bojatisjes të njohin hapat e punimit me dorë dhe në kompjuter për përgatitjen e bojërave sipas kërkesës.
- të njohin sipërfaqet prej druri e metali që do të bojatisen duke specifikuar përpunimin e tyre para bojatisjes.
- të njohin llojin e bojërave që do të përdoren për bojatisjen në sipërfaqet prej druri e metali sipas kërkesës.

**RM 2 Nxënësit veshin me letër murale sipërfaqet e brendshme.*****Përmbajtja:***

- Përgatitja e vendit të punës, përzgjedhja e mjeteve dhe materialeve.
- Fiksimi i skelës së gatshme.
- Kontrolli i rrafshhtësisë së sipërfaqes që do të vishet (mur, shtyllë, tra etj.).
- Smerilimi i sipërfaqes që do të vishet dhe pastrimi i saj nga pluhurat.
- Matja e përmasave të sipërfaqes që do të vishet, shënimi i tyre në e letër dhe prerja e saj.
- Lyerja e sipërfaqes që do të vishet me materialin ngjitës.
- Ngjitja në sipërfaqe dhe ngjeshja e letrës murale për radhën e parë, për radhën e dytë e të radhëve të tjera.
- Matja, shënimi dhe prerja e letrës murale për pjesët plotësuese dhe të aksesorëve të ndryshëm.
- Ngjitja dhe ngjeshja e letrës murale në sipërfaqet plotësuese dhe të aksesorëve të ndryshëm.
- Pastrimi i sipërfaqes së veshur me letër murale.
- Pastrimi dhe mirëmbajtja e mjeteve të punës për veshjen e sipërfaqeve të brendshme me letër murale.
- Sistemimi i vendit të punës pas punimit të veshjes së sipërfaqeve të brendshme me letër murale.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të përgatisin vendin e punës, të përzgjedhin mjetet dhe materialet e punës sipas kushteve teknike.
- të fiksojnë skelën e gatshme sipas kushteve teknike.
- të kontrollojnë sipërfaqen që do të vishet (mur, shtyllë, tra etj.) me instrumentet matëse dhe niveluese.
- të smerilojnë sipërfaqen që do të vishet dhe ta pastrojnë atë nga pluhurat sipas kushteve teknike.
- të masin përmasat e sipërfaqes që do të vishet, t'i shënojnë ato në letrën murale të radhës së parë, të radhës së dytë etj. dhe ta presin atë me saktësi sipas konfigurimit real të sipërfaqes dhe dekoracionit të letrës.
- të lyejnë sipërfaqen që do të vishet me materialin ngjithës sipas kushteve teknike.
